

Drejtuar presidentit Ramiz Alia

- Ne jemi përkrahës të reformave demokratike të nisura nga presidenti Alia dhe jemi për shpejtimin e tyre. Ky ishte dhe qëllimi I manifestimeve tona paqesore.
- Kërkojmë fajtorët të cilët dhanë urdhër të përdoret dhune mbi studentet. Kërkojmë që ata të gjykohen para Qytetit Studenti.
- Kërkojmë të krijohet një komision prej studentësh dhe mjekësh për të verifikuar gjendjen e studentëve të plagosur.
- Kërkojmë pluralizëm politik si shkala më e lartë e demokracisë së sotme, si pasojë:
 - Të lejohet krijimi i Organizatës së Pavarur Demokratike të Studentëve dhe Intelektualëve të Rinj. Status i së ciles do të paraqitet për legalizim në Ministrinë e Drejtësisë.
 - Duam që ajo organizatë të ketë deputetët e vet në Kuvendin Popullor.
- Të botohen kartat e OKB-së, Karta e Helsinkit 1 dhe 2, si dhe Karta e Parisit.
- Kërkojmë liri të shtypit dhe të fjalës, pa censurë.
- Kërkojmë të sqarohet opinioni publik mbi të vërtetën e lëvizjes studentore.
- Kërkojmë të gjenden rrugë dhe zgjidhje sa më të shpejta dhe efikase për të dalë nga gjendja e krizë ekonomike në të cilën ndodhemi.
- Kërkojmë takim me Presidentin Alia.
- Për sa më sipër, në mbrojtje të të cilave janë gjithë studentët dhe ashtu siç ju garanton ligji, kërkojmë që studentet të mos ndiqen penalisht, kategorikisht të mos përdoret dhuna dhe presioni dhe të mos persekutohen në mënyrë të tërthortë.

U bëjmë thirrje të gjithë intelektualëve, personaliteteve, të gjithë atyre që e duan SHQIPËRINE të mbështesin kërkesat tona dhe të bashkohen me ne.

Qyteti Studenti më 10.12.1990